

KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, SHGM, duke vepruar në bazë të ankesës së Vlladimir Zdravevit dhe Hotelit "Solun", të dorëzuar nga avokatët Kamelia Stoev dhe Goran Stoev kundër Biljana Stavrovës, gazetare e TV Tellma, për shkelje të prezumimit të pafajësisë, nga 30.12.2023, në seancën e Këshillit të mbajtur më 30 janar 2024 në Shkup, solli këtë

V E N D I M

ANKESA E VLLADIMIR ZDRAVEVIT DHE HOTELIT SOLUN KUNDËR GAZETESËS BILJANA STAVROVA NGA TV TELLMA REFUZOHET, SEPSE NUK JANË SHKELUR DISPOZITAT E KODIT TË GAZETARËVE PËR SHKELJE TË PREZUMIMIT TË PAFAJËSISË

A r s y e t i m

Parashtruesit, në një Ankesë të datës 30.12.2023, dërguar Këshillit të Nderit në SHGM, pretendojnë se është cenuar prezumimi i pafajësisë së Vlladimir Zdravevit, me faktin se emri i tij është përmendur në lajmet e TV Tellma më 27.12.2023, nga gazetarja Biljana Stavrova, si dhe është dëmtuar imazhi dhe funksionimi i biznesit të Hotel "Solun", pasi është bërë e ditur se është kërkuar konfiskim për hotelin.

Këshilli i Nderit pranë SHGM, duke shqyrtuar parashtresën e paraqitur, si dhe lajmin e publikuar në TV Tellma, konstatoi se ankesa është e pabazuar për këto arsye:

- Raportimi gazetaresk bazohet në njoftimin e Prokurorisë Publike për akuzat e ngritura kundër Vlladimir Zdravevit dhe të tjerëve, për disa vepra penale, në rastin me titullin punues "Feniks" ose për keqpërdorim të mjeteve për prodhimin e monumenteve nga projekti "Shkupi 2014".

Parashtruesi i ankesës Vlladimir Zdravev, në kohën e kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet nga Prokuroria për Ndjekje të Krimin dhe Korrupsionit, ka qenë funksionar publik, kryetar i Këshillit të Komunës Qendër në Shkup dhe paratë për të cilat bëhet fjalë në akuzë ishin të buxhetit vendor ose të shtetit, domethënë paratë e taksapaguesve.

Prandaj, duke vlerësuar të gjithë kontekstin, Këshilli vlerëson se gazetari (si dhe të gjithë të tjerët që publikuan detaje dhe informacione për akuzën e ngritur) kishin një qëllim legjitim dhe një interes të lartë publik për të informuar rreth temës.

Këshilli i Nderit nuk i ka pranuar argumentet në ankesë se emri i Zdravevit nuk është përmendur në informacionin e Prokurorisë, e as Hoteli “Solun” për të cilin janë marrë masat.

Këshilli i Nderit thekson se gazetarët nuk janë vetëm transmetues të njoftimeve nga autoritetet shtetërore, por kanë të drejtë legjitime të hetojnë përtej kësaj, veçanërisht për rastet në të cilat ka një interes të lartë publik, si ai i përmendur për ndërtimin e monumenteve, të paguara me paratë e buxhetit. Në thelb, ky është roli i gazetarisë investigative.

Duke qenë se bëhet fjalë për aktakuzë, për të cilën ka pasur hetim, paraburgim dhe masa të tjera, nuk mund të bëhet fjalë për cenim të prezumimit të pafajësisë, sepse në raportim nuk ka konstatime se personi është fajtor dhe nuk është sugjeruar ndonjë vendim gjykate.

E njëjta gjë vlen edhe për hotelin “Solun”, për të cilin është kërkuar masë sigurie (konfiskim), si rezultat i një hetimi të përfunduar për vepër penale siç është ajo për “pastrim parash”. Vendimet për masat merren nga Gjykata dhe raportet e mediave nuk mund të ndikojnë në të dhe as veprimtaria e biznesit të hotelit nuk mund të varet prej tyre.

Sipas Kushtetutës: “Personi i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.” Pra, askush nuk mund të konsiderohet fajtor për një krim të caktuar derisa gjykata të konstatojë fajësinë e tij.

Nenet 7 dhe 8 të Kodit të Gazetarëve përcaktojnë se: - Gazetari duhet të respektojë privatësinë e personit, me përjashtim të rasteve kur kjo bie ndesh me interesin publik.

- Mënyra e informimit në rastet e aksidenteve, fatkeqësive natyrore, luftërave, tragjediive familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jetë pa sensacion. Në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në kontest dhe të mos sugjerohet asnjë aktgjykim.

Duke vlerësuar përmbajtjen e informacionit të publikuar, dispozitat e Kushtetutës, Ligjit për Procedurë Penale, praktikës së GJEDNJ-së dhe Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë, Këshilli i Nderit nuk konstatoi shkelje të Kodit dhe vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendosur në Shkup më 30 janar 2024

-T'i dorëzohet parashtruesit nëpërmjet avokatëve dhe të publikohet në ueb faqen e SHGM-së.

СОВЕТ НА ЧЕСТА



ОДЛУКИ ОД СОВЕТ НА ЧЕСТ

www.znm.org.mk

Këshilli i Nderit në SHGM

Sashe Dimovski

Kryetar

